



22.04		1	
SKIMSHICK	1956/2021	117	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.97/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.97/2021 të datës 24.02.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë, rruga "Naim Gashi" ndërtesa e komunës Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 në paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.97/2020 të datës 24.02.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.13-116/01-0006334/2021 i datës 26.01.2021, i Komisionit Disiplinor i Komunës së Podujevës.

III. ANULOHET Vërejtja me shkrim e datës 28.12.2020, e shqiptuar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të arsimit në komunën e Podujevës për ankuesin.

IV. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Podujevës dhe Menaxheri i Personelit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit vërejtjen me shkrim të datës 28.12.2020 nga dosja personale e ankuesit, si dhe të bëjë kompensimin e pagës së ndaluar për muajt e përcaktuar në vendim të Komisionit Disiplinor.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Podujevës sipas Akt emërimit të datës 01.12.2012, në pozitën "Zyrtar i Lartë i Arsimit" në Drejtorin e Arsimit, me datën 28.12.2020, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës i ka shqiptuar masën "Vërejtje me shkrim", për mos ofrimin e informatave dhe dokumenteve që lidhen me kohën sa ishte „Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit“ në Komunën e Podujevës të kërkuara nga Agjencia Kundër Korrupsion.

Po ashtu me datën 30.12.2020, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, parashtron kërkesë me për iniciimin e procedurës disiplinore, për nëpunësin civil për shkak të shklejeve të supozuara të rënda të punës.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës, me datën 26.01.2021, nxjerr Vendim me numër Nr.13-116/01-0006334/2021, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim i 20% të pagës për periudhën prej 3 muajve nga data 01.02.2021 deri me 30.04.2021".

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës, me datën 24.02.2021, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 808/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 01.03.2021, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Podujevës, ndërsa Këshilli me datën 01.03.2021 ka pranuar nga Komuna e Podujevës, përgjigjen në kërkesë me numër protokollit: 1169/2021, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.04.2021 ka nxjerr Vendim për zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit edhe për dhjetë ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me Nr. Prot: 808/2021 e datës 24.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 26.01.2021 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës; Vërejtje me shkrim për ankuesin e datës 28.12.2020; Informatë e datës 24.12.2020 nga ankuesi për Drejtorin Komunal të Arsimit në Komunën e Podujevës; E-maili zyrtar i datës 28.12.2020; Ftese për seancë disiplinore për ankuesin e datës 12.01.2021; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 14.01.2021; Ftesë për seancë disiplinore e datës 14.01.2021; Kërkesë e datës 30.12.2020 për Komisionin disiplinor për ankuesin e datës 30.12.2020; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 30.12.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.03.2021, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ; Përgjigje në ankesë e datës 16.03.2021, nga Komuna e Podujevës me shkresat e bashkangjitura; Akt emërim i ankuesit i datës 01.12.2012; Vendim i datës 09.01.2019 për emërimin e drejtorit të drejtorisë së arsimit ne komunën e Podujevës; Vendim i datës 01.03.2018 për emërimin e ushtruesit te detyrës te drejtorit te drejtorisë se arsimit ne



komunën e Podujevës; Përshkrimi i detyrave të punës për nëpunësin e arsimit; Lista e kandidatëve për mësimdhënës në konkursin e datës 19.07.2019, nr.05/247 për testim me shkrim; Konkurs për mësimdhënës në komunën e Podujevës për vitin shkollor 2019/2020; Kontrata e punës e datës 01.09.2019 për Alban Sylën; Kontrata e punës e datës 07.10.2019 për Vendim i datës 14.12.2020 për themelimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor të komunës së Podujevës; Vendim i datës 26.01.2021 për shqiptimin e masës disiplinore për ankuesin; Procesverbal i seancës dëgjimore të komisionit disiplinor i datës 18.01.2021; Procesverbal i seancës së komisionit disiplinor i datës 13.01.2021; Procesverbal i seancës së komisionit disiplinor i datës 13.01.2021; Kërkesa për pushim e datës 11.12.2020 për ankuesin; E-maili zyrtar i datës 24.12.2020; E-maili zyrtar i datës 23.12.2020; Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Agjencia kundër korrupsion e datës 23.12.2020; Përgjigje në shkresën e drejtorit nga ankuesi e datës 09.12.2020; Informatë nga ankuesi për drejtorinë komunale të arsimit në komunën e Podujevës e datës 24.12.2020; Formulari për kërkesë apo ankesë i ankuesit i datës 09.12.2020; Vërejtje me shkrim për ankuesin e datës 28.12.2020; E-maili zyrtar i datës 28.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar për shkak të shkeljeve procedurale dhe ligjore të bëra nga organi i punësimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në baze të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se ushtruesi i detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, nga Agjencia Kundër Korrupsioni me date 23.12.2020 ka pranuar kërkesë me të cilën ka kërkuar që brenda dy dite të sigurohet informacionet se mbi çfarë baze janë lidhur kontrata nr. 926/2 e datës 07.10.2019 për në pozitën "Arsimtar i matematikës" në SHFMU "Zahir Pajaziti" në fshatin Orllan, Komuna e Podujevës dhe Kontrata nr.761/2 e datës 01.09.2019 për në pozitën "Arsimtar i matematikës" në SHFMU "Kongresi i Manastirit" në fshatin Gllanmik, komuna e Podujevës. A ka pasur procedurë paraprake që lidhen e këtyre kontratave të cekura më lartë, nëse po, të bashkëngjitet komplet kopje dokumentacioni relevant që nga iniciimi i shpalljes së konkursit deri të nënshkrimit të kontratave, duke përfshirë dosjet personale të kandidatëve që kanë aplikuar, dokumentacionin mbi vlerësimin, nëse jo të jepet arsyetim i detajuar lidhur me këtë, i cili menjëherë e ka njoftuar ankuesin dhe ka kërkuar nga ai që të përgjigjet në kërkesën e datës 23.12.2020 të Agjencisë Kundër Korrupsion. Në bazë të dëshmisë së ofruar nga organi i punësimit, konkretisht kërkesës për pushim vjetor të miratuar me datës 11.12.2020 ka konstatuar se edhe pse ankuesi ka qenë në pushim vjetor nga data 14.12.2020 deri me date 31.12.2020, ai ka ndërprerë pushimin dhe me datën 24.12.2020, i ka ofruar informatat dhe dokumentet e kërkuara Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës.

Me datën 28.12.2020, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me shkrim", me arsyetimin se ankuesi nuk ka ofruar informatat dhe dokumente të nevojshme të kërkuara nga Agjencia Kundër Korrupsion që lidhen me kohën kur ankuesi ishte „Drejtore i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Podujevës, ndërsa me datën 30.12.2020, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e



Podujevës parashtron kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore, për nëpunësin civil nën dyshimin e bazuar se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të obligimeve dhe përgjegjësi të punës, për shkak të mos ofrimit të informatave dhe dokumenteve të kërkuara nga Agjencia Kundër Korrupsion.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës, më datë 26.01.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr. 13-116/01-0006334/2021 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim i 20% të pagës për pertudhën prej tre (3) muajve nga data 01.02.2021 deri me 30.04.2021"*, për shkak se me veprimin e tij ankuesi ka kryer „Shkelje të përsëritur të rregullave të Kodit të Etikës në Shërbimin Civil“ e cila kualifikohet si shkelje e rëndë e obligimeve dhe përgjegjësi të punës, sipas nenit 46 paragrafit 3, nën paragrafit 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi me datë 24.02.2021 ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin ka kërkuar anulimin e vërejtjes me shkrim e datës 28.12.2020 të shqiptuar nga Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Arsimit në Komunën e Podujevës dhe anulimin e vendimit me numër Nr.13-116/01-0006334/2021 të datës 26.01.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës, për arsyeje të Zbatimit të gabuar të dispozitave juridike, gjegjësisht shkeljes së dispozitave procedurale dhe materiale; si dhe Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit respektivisht pretendimin për anulimin e masës disiplinore *"vërejtje me shkrim"* të datës 28.12.2020, konstaton se vërejtja me shkrim e datës 28.12.2020 nuk përmban të gjitha elementet e aktit administrative siç parashihet me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nuk përmban këshillën juridike, në këtë kuptim nëse një akt nuk përmban një element të tillë, atëherë afati për parashtrim të ankesës ndaj tij është tre muaj siç parashihet me nenin 127 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe dëshmive të ofruara në lëndë, konstaton se Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, me rastin e shqyrtimit të „vërejtjes me shkrim“ për ankuesin nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatim apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, e që në rastin konkret, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, nuk ka marrë për bazë deklarinin e ankuesit të dhënat e



ofruara dhe dokumentet e bashkangjitura në informatën e datës 24.12.2020, andaj me të drejte Kolegji konstaton se Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit përveç që nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike ai nuk ka arritur të vërtetoj as gjendjen juridike sepse në „vërejtjen me shkrim“ nuk i është referuar asnjë dispozite të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, respektivisht nuk ka konstatuar shkeljet e kryera nga ankuesi, gjegjësisht nuk ka konstatuar që me veprimet apo mos veprimet e tij gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të lehta apo të rënda-serioze të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që masa disiplinore „vërejtje me shkrim“ e datës 28.12.2020 e shqiptuar ndaj ankuesit përveç që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publike është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara në lëndë, ka konstatuar se Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Arsimit në Komunën e Podujevës dy dite pas shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit „vërejtje me shkrim“ me datën 30.12.2020, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit nën dyshimin e bazuar se ankuesi me veprimin e tij ka kryer shkelje të rëndë të obligimeve dhe përgjegjësi të punës, sipas nenit 46 paragrafit 3, nën paragrafit 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 7 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, respektivisht me arsyetimin e njëjtë për mos ofrimin e informatave dhe dokumenteve të kërkuara nga Agjencia Kundër Korrupsion, informata që lidhen me periudhën kur ankuesi ishte „Drejtore i Drejtorisë Komunale të Arsimit“ në Komunën e Podujevës, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës, më datë 26.01.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr. 13-116/01-0006334/2021 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *“Ndalim i 20% të pagës për periudhën prej tre (3) muajve nga data 01.02.2021 deri me 30.04.2021”*, për shkak se me veprimin e tij ankuesi ka kryer „Shkelje të përsëritur të rregullave të Kodit të Etikës në Shërbimin Civil ‘e cila kualifikohet si shkelje e rëndë e obligimeve dhe përgjegjësi të punës, sipas nenit 46 paragrafit 3, nën paragrafit 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokolli Nr. 13-116/01-0006334/2021 të datës 26.01.2021, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore *“Ndalim i 20% të pagës për periudhën prej tre (3) muajve nga data 01.02.2021 deri me 30.04.2021”* ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për



Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se „Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. „Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura“ dhe 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore“ dhe në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se; „Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përprjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit“ sepse në rastin konkret Komisioni nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat dhe faktet, nuk ka marrë për bazë deklarinë e ankuesit të dhënat e ofruara dhe dokumentet e bashkangjitura në informatën e datës 24.12.2020, si dhe po ashtu nuk ka marrë për bazë përprjekjen e ankuesit i cili ka ndërprerë pushimin vjetor dhe është përgjigjur në kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ndërsa sa i përket dosjeve personale të mësimdhënësve në fjalë pretendimi i ankuesit mbështetet në faktin se dosjet i posedon Zyra e Personelit dhe jo ai.

Kolegji po ashtu ka konstatuar se ndaj ankuesit për të njëjtin supozim të shkeljes i është shqiptuar një masë disiplinore “vërejtje me shkrim”, nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë me datë 28.12.2020 andaj mbi bazë të kësaj Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”, meqenëse Komisioni Disiplinor i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore për të njëjtën rrethanë që i është shqiptuar një masë tjetër brenda një afati kohor prej një muaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Vendimi me numër Nr.13-116/01-0006334/2021 i datës 26.01.2021, i Komisionit Disiplinor i Komunës së Podujevës është i paligjshëm dhe është në kundërshtim të plotë me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3, 1.5 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Meqenëse Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër Nr.13-116/01-0006334/2021 i datës 26.01.2021, i Komisionit Disiplinor i Komunës së Podujevës është i paligjshëm, atëherë Kryetari i Komunës së Podujevës dhe Menaxheri i Personelit, janë të obliguar që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit vërejtjen me shkrim të datës 28.12.2020 nga dosja personale e ankuesit, si dhe të bëjë kompensimin e pagës së ndaluar për muajt e përcaktuar në vendim të Komisionit Disiplinor.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafi 1 të këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.97/2021

Ardita Perçuku-SHYTI

*Procesbajtëse*

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

*Kryetare e Kolegjit*

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.